

# KONTRATA E THEMELIMIT DHE STATUTI

## I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 05.10.2020

1. **Z. OLTJAN HASALLA** i dat.29.01.1981 dhe me nr ID: I10129159R

2. **Z. ENERJAN GREMI** i dat.28.01.1990 dhe me nr ID.:J001280240

qe ne vijim do te quhen ortake: Bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar " **SINERGY CONSULTING**" Shpk, ne baze te kushteve qe vijojne:

#### Kreu I

#### **OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Projektim, ndertim, instalim dhe tregtimi i sistemeve te energjise se rinovueshme, parqeve e fermave diellore, parqet e eres nepermjet turbinave. Ndertimi i veprave hidroenergjetike. prodhim energjie elektrike, furnizimin ose tregtimin e energjise elektrike ne cfaredolloj forme, eksportimin e energjise elektrike jashte Republikes se Shqiperise, importin e energjise elektrike hrenda territorit te Republikes se Shqipërisë. Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi. Sherbime planifikimi urban, masterplane, plane vendore, PPV. planifikime territoriale. kombetare. projektim, mbikqyrje, supervizim, ko/audim punimesh. Kryerja e stidimeve per projektet ne fushen e energjise se rinovueshme, ngrohjes, gazit, duke pershire paisjet hidraulike dhe instalimet elektrike. Perfaqesimin e shoqerive te ndryshme Shqiptare apo te huaja, qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie. Ndermjesim me komision per blerjen, shitjen, prodhimin dhe instalimin e sistemeve te energjise se rinovueshme. Per qellimet e mesiperme shoqerise mund te, ne rruge direkte dhe pa kufizime, te realizoje lidhjen e marreveshjeve franchising agjenci, komision, urdher, blerje, perdorim dhe transferimin e patentave dhe marka tregtare. njohurive dhe veprave te tjera te pronesise intelektuale, te sipermarrjes se perbashket, ose si i shoqeruar edhe si nje shok dhe qira te korporatave, marre perfaqesues me ose pa depozite dhe agjencive, si dhe kerkimin e marketing dhe perpunimin e te dhenave, per te dhene dhe per te marre licencat e shfrytezimit tregtar. Shoqeria mund te kryeje aktivite te tregtare, industriale, te pasurive te paluajtshme, letrave me vlere dhe financare, keto te fundit jo kundrejte publikut, te nevojshme ose te dobishme per permbushur objektet e saj, duke perfshire marrjen dhe asgjesimin e interesave te enteve, shoqerive, gjithashlu duke pasur te drejte dhe per te nderhyre ne themelimin e tyre. Ajo gjithashtu mund te leshoje garanci te kredise si reale dhe personale edhe ne favor te paleve te tretat me qellim permbushjen dhe realizimin e objektit te shoqerise. Te gjilha aktivitet duhet te kryhen brenda kufijve dhe ne perputhje me rregullat dhe normat nga te cilat parashikohet ushtrimi i tyre

objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtsnme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtsnme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

## **Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise**

2.1. Ortaket vendosen qeshoqerine ta emertojne **SINERGY CONSULTING Shpk**

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne *Tirane Njesia Bashkiake Nr.2, Rr.Fatmir Haxhiu Pallati ETC Hyrja nr.8,kati 10,Apr 10/2*

2.3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni.3. Regjimi Juridik**

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtasin Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT,KOHEZGJATJA**

## **Neni 4.Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut**

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet

per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

**4.5.**Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet,llogarite ekonomike, etj

**4.6.**Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar

### **Neni 5.Kohezgjatja**

**5.1.**Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

## **Kreu III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

**6.1.** Kapitali themeltar eshte 100 000(Njeqin mije) leke dhe eshte i ndare ne 2 kuota

**6.2.**Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

- **Z. OLTJAN HASALLA** 60 000 – 1 kuote, perkatesisht 60%
- **Z. ENERJAN GREMI** 40 000 – 1 kuote, perkatesisht 40%

**6.3.**Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket

**6.4.**Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

#### **Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar**

**7.1.**Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise.

**7.2.**Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakeve

## **Kreu IV**

### **DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**

#### **Neni 8**

**8.1.** Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**8.2.** Emertimi i shoqerise tregtare,kapitali themeltar,NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

**8.3.** Organet kryesore te shoqerisa jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortaket,administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

## **Neni 9**

### **Asambleja e Pergjithshme e shoqerise**

Asambleja e pergjithshem perbehet nga ortaket e shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaket. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori,Eksperti kontabel i autorizuar ose ortaket e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin,daten,oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaket mund te perfaqesohen ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi,duke qene i autorizuar me prokure te posacme,dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Ortaku mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar,duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar. Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast,ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaku i vetem.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen ne nje regjister te vendimeve,te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket e shoqerise kane te drejte te marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.



- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) Miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- i) Ceshnje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

## **Kreu V**

### **ADMINISTRIMI**

#### **Neni 10**

**10.1.** Shoqeria do te administrohet nga 1 (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise

**10.2.** Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaket

**10.3.** Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori Z. OLTJAN HASALLA**

**10.4.** Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese)vjet me te drejte ripertesitje ne perfundim te mandatit.


**10.5.** Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

**10.6.** Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

**10.7.** Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres

**10.8.** Kompetencat kryesore te administratorit ne shoqeri jane:

- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaket :
- perfaqeson shoqerine tregtare.
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim
- krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit



- raporton perpara ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.
- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku i vetem.
- kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise
- te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- ti propozoje ortakeve per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
- ti propozoje ortakeve per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

### **Neni 11-Marreveshjet e ndaluara**

**11.1.**Administratorit ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejoht te kontraktojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve .Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike.

**11.2.**Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj çdo personi ndermjetes.

## **Kreu VI**

### **VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 12**

**12.1.**Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.




**12.2.**Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaket.

**12.3.**Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### **Neni 13-Kontrolli i Shoqerise**

**13.1.**Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortaku i vetem.

**13.2.**Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar , si dhe gjendjen financiare te shoqerise.Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon ghithe librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve.Mund te aktivizojte eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

**13.3.**Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakeve.

## **Kreu VII**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 14**

**14.1.**Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

**14.2.**Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij procesi, ortaku i vetem emerion nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

**14.3.** Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapilit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakët e shoqerise.

#### **Neni 15.Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

15.1.Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

### **Kreu VIII**

#### **DISPOZITA TE FUNDIT**


#### **Neni 16**

16.1.Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent

16.2.Ky staut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore.Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

### **ORTAKET**

**Z. ENERJAN GREMI**

*Enerjan Gremi* 

**Z. OLTJAN HASALLA**

*Oltjan Hasalla* 